

## Çfarë është Ndërmjetësimi?

Ndërmjetësimi është një proces jashtëgjyqësor ku ndërmjetësi ndihmon palët për gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët për mosmarrëveshjen e tyre, në përputhje me ligjin.

Nëse keni një mosmarrëveshje në fushën e:

- ◆ Pronësisë
- ◆ Detyrimeve
- ◆ Kontratave
- ◆ Marrëdhënieve tregtare
- ◆ Marrëdhënieve të punës
- ◆ Familjares
- ◆ Pronësisë intelektuale, të drejtave të konsumatorëve
- ◆ Mosmarrëveshjeve midis organeve të administratës publike dhe subjekteve private
- ◆ Së drejtës penale për vepra që ndiqen me kërkesë të viktimës akuzuese ose me ankim të të dëmtuarit
- ◆ Çështjeve penale ku përfshihen të mitur, sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur

**NDËRMJETËSIMI ËSHTË ZGJEDHJA E DUHUR PËR JUI!**



## Parimet themelore të Ndërmjetësimit

- ◆ Vullneti i Lirë i palëve
- ◆ Paanshmëria e ndërmjetësit
- ◆ Drejtësia dhe Integriteti
- ◆ Barazia e Palëve
- ◆ Konfidencialiteti
- ◆ Transparenca



## Përfitimet e shërbimit të Ndërmjetësimit:

- ◆ Zgjidhje e shpejtë dhe efektive e mosmarrëveshjes
- ◆ Kosto më e ulët se një proces gjyqësor
- ◆ Marrëveshja përbën titull ekzekutiv
- ◆ Palët zotërojnë procesin
- ◆ Procesi i ndërmjetësimit mund të fillojë edhe nëse çështja është regjistruar në Gjykatë
- ◆ Ofron zgjidhje të reja për palët
- ◆ Procesi është konfidencial
- ◆ Përmirëson komunikimin dhe zbut konfliktin midis palëve.
- ◆ U jep mundësinë palëve të shprehin emocionet shqetësimet dhe problemet që shkaktohen nga konflikti.

**ASPEKTI NJERËZOR ËSHTË THELBËSOR NË NDËRMJETËSIM!**





# Kush jemi?

● CSSP - Qendra në Berlin për Ndërmjetësim Integruar është një organizatë jofitimprurëse me seli në Berlin, Gjermani dhe me zyra vendore në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Shqipëri. Ajo ka ushtruar aktivitetin e saj në Gjermani, Maqedoninë e Veriut, Ukrainë, Egjipt dhe Nepal.

● Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve (DHKN) është Ent Publik Juridik i pavarur, krijuar me 7 korrik 2013, që ushtron veprimtarinë në bazë të Ligjit nr.10385 datë 24.2.2011, i ndryshuar. DHKN rregullon dhe kontrollon ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit, miraton aktet që rregullojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit si profesion dhe organizon trajnimet fillestare për kandidatët për ndërmjetës dhe trajnime vazhduese për ndërmjetësit.

● Fondacioni "Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve" (FZKPM) është një organizatë jofitimprurëse profesionale, me një përvojë 28-vjeçare në promovimin, zhvillimin dhe zbatimin e Zgjidhjeve Alternative të Mosmarrëveshjeve, ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese në Shqipëri.

Duke filluar nga dhjetori 2021, CSSP në partneritet me DHKN dhe FZKPM, me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë, po zbatojnë projektin "Zgjerimi dhe Fuqizimi i Sistemit të Ndërmjetësimit në Shqipëri" financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim.

## Ku mund të gjej një ndërmjetës?

- Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve Tiranë: Rruga Brigada 8, Pallati Tekno-Projekt, kati 4.
- Zyra e Ndërmjetësimit Tiranë: Blv. Gjergj Fishta, Rr. Astrit Balluku, Nd. 2, Hyrja 3, Ap. Nr. 13 (pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë)
- Dega Vendore e DHKN-së Durrës Rr. "Aleksandër Goga" (përballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës).
- Dega Vendore e DHKN-së Elbasan Rr. "Lef Nosi" Lagjja "5 Maji" (pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan)
- Dega Vendore e DHKN-së Vlorë Rr. "Sulejman Delvina", Lagjja "Hajro Cakëri", pranë shkollës 9-vjeçare "Muco Delo".

Për më shumë informacion:

[www.dhkn.gov.al](http://www.dhkn.gov.al) [www.qendrandermjetesimit.al](http://www.qendrandermjetesimit.al)

email: [tirana@qendrandermjetesimit.al](mailto:tirana@qendrandermjetesimit.al)

☎ +355 69 322 13 14

09.00 - 18.00, nga e hëna në të premte.



Kjo fletëpalesje u realizua në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor në kuadër të zbatimit të planit të komunikimit për Gjykatat 2022 -2024



financuar nga:

Austrian Development Cooperation